



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë: 19.04.2024



Npi – 01/146 datë: 29.04.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), nenin 14 dhe 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neni 7 paragrafi (1 dhe 3) si dhe neni 21 i Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092; Kuvendi Komunës, pasi analizoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, dhe propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në seancën e mbajtur më 29.04.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi-01/85 TË DATËS 15.03.2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi SHFUQIZIMIN e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/85 të datës 15.03.2023, për destinimin e pronës Komunale për komunitetin e fshatit Pjetërshticë, për ta shfrytëzuar përkohësisht, për ndërtimin e një “Objekti të Ngushllimeve”, në pjesën e ngastrës kadastrale numër P-72809064-01514-1, me sipërfaqe prej S=500m² në Zonën Kadastrale – Pjetërshticë, Evidentuar Pasuri e Komunës së Shtimes.

II


A r s y e t i m: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) e ka njoftuar Kuvendin e Komunës së Shtimes me aktin Nr.02-1532-2/2023 të datës 03.04.2023 e cila konfirmon se Vendimi i Kuvendit Npi-01-85 i datës 15.03.2023, për destinimin e pronës Komunale për komunitetin e fshatit Pjetërshticë, me qëllim të shfrytëzimit përkohësisht, për ndërtimin e një “Objekti të Ngushllimeve”, nuk është në përputhje me ligjin. Kuvendi i Komunës e ka analizuar aktin e vlerësimit të ligjshmërisë që i është bërë nga MMPHI-ja, si dhe propozimin e DPUKGJ-së Nr.02/323 të datës 22.04.2024 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit, dhe ka marrë vendim sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi